

VENDIM
Nr. 448, datë 22.7.2021

**PËR MIRATIMIN E ÇMIMEVE DHE TË KATEGORIVE QË PËRFITOJNË
FALAS TEKSTET E BOTUARA NGA QENDRA E BOTIMEVE PËR
DIASPORËN, PËR VITIN SHKOLLOR 2021–2022**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të pikës 5, të nenit 10, të ligjit nr. 16/2018, “Për diasporën”, të ndryshuar, të ligjit nr. 9616, datë 27.9.2006, “Për librin në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të ligjit nr. 137/2020, “Për buxhetin e vitit 2021”, të ndryshuar, dhe në zbatim të pikës 19, të vendimit nr. 469, datë 26.7.2018, të Këshillit të Ministrave, “Për krijimin, organizimin dhe funksionimin e Qendrës së Botimeve për Diasporën”, me propozimin e ministrit të Shtetit për Diasporën, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Me qëllim mbështetjen e mësimi të gjuhës shqipe dhe të kulturës shqiptare në diasporë, Qendra e Botimeve për Diasporën boton, siguron dhe shpërndan për kategoritë që përfitojnë falas tekstet shkollore për vitin shkollor 2021–2022, sipas listës 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Kategoritë, që përfitojnë falas tekstet shkollore të botuara, të siguruara nga Qendra e Botimeve për Diasporën, janë nxënësit dhe mësuesit, sipas përcaktimeve të vendimit nr. 443, datë 26.6.2019, të Këshillit të Ministrave, “Për organizimin e procesit mësimor dhe përzgjedhjen e arsimtarëve në diasporë”.

3. Tekstet shkollore të botuara, të siguruara nga Qendra e Botimeve për Diasporën, duhet të jenë të pajisura me logon dhe pullën me hologram përkatëse.

4. Çmimet e teksteve shkollore për mësimdhënien në diasporën shqiptare vendosen në kopertinën e tyre, në përputhje me listën 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

5. Efektet financiare të këtij vendimi, ku përfshihen botimi, ambalazhimi dhe shpërndarja, të përballohen nga buxheti i miratuar për Qendrën e Botimeve për Diasporën.

6. Ngarkohen ministri i Shtetit për Diasporën dhe Qendra e Botimeve për Diasporën për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Erion Braçe

LISTA 1
TEKSTE SHKOLLORE PËR DIASPORËN
PËR VITIN SHKOLLOR 2021–2022

Titulli i librit	Sasia	Çmimi për copë/lekë referuar çmimit në kopertinën e librit
Të mësojmë gjuhën amtare 1	4303 copë	340
Të mësojmë gjuhën amtare 2	3808 copë	340
Të mësojmë gjuhën amtare 3	2985 copë	340
TOTALI	11 096 copë	

* TVSH-ja për librin sipas ligjit nr. 96/2018 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 92/2014, “Për tatimin mbi vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisë” të ndryshuar është 6% (gjashtë).